

NEVOJA PËR TË ARDHURA DHE ANALIZA E TARIFAVE/STRATEGJIA E PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT

Procesi i hartimit të Planit të Biznesit përfundon duke konsideruar gjithë nevojat për të ardhura (kostot operative, borxhet, rezervat kapitale), me një analizë të tarifave të përsëritur që mund t'i detyrojë drejtuesit të rishqyrtojnë buxhetin e operimit dhe mirëmbajtjes. Pasi të jetë llogaritur një "tarifë mesatare" realiste, atëherë mund të zhvillohet strategjia për përcaktimin e çmimeve për të reflektuar ndonjë diferencim ndërmjet kategorive të përdoruesve (klientëve).

MODELI NË EXCEL I PLANIT TË BIZNESIT

	• Analiza dhe parashikimi i strukturës së personelit
	• Analiza e kërkesës për ujë dhe parashikimi i shitjeve
	• Investimet kapitale dhe parashikimi i shpenzimeve kapitale
	• Programi i shërbimeve kapitale dhe borxhit

Modeli i Planit të Biznesit i hartuar për tu përdorur në kursin e trajnimit të SHUKALB, i zbatuar në më shumë se pesë vende të Ballkanit, Lindjes së Mesme dhe Azisë, është një qasje sasiore e planifikimit të biznesit, e mbështetur plotësisht dhe nga një Model i programuar në Excel, për të shërbyer si një mjet ndihmes për rishikimin dhe përditësimin vjetor të planit të biznesit, si dhe për vlerësimin e progresit të bërë në përmirësimin e performancës së shoqërisë.

Modeli në Excel i Planit të Biznesit do të ndihmojë Shoqërinë dhe Bashkinë për llogaritjen e treguesve kryesorë të performancës, që do të nevojiten gjatë procesit të negociimit të Marrëveshjes së Performancës, që do të zbatohet ndërmjet Asamblesë së Përgjithshme dhe Bordit Administrativ të Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime, si dhe marrëveshjes që do të zbatohet ndërmjet Bashkisë dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktursë.

REZERVONI TANI VENDIN TUAJ NË KURSIN E TRAJNIMIT TË PLANIT TË BIZNESIT PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS

Kurset do të fillojnë të jepen në shtator 2016, dhe do të konsistojnë në katër seanca të ndara

trajnimi. Në secilën seancë do të kërkohet përgatitje paraprake nga ana e Shoqërisë dhe Bashkisë, për të ardhur në trajnim të përgatitur për të plotësuar modelin e Planit të Biznesit me të dhënat e shoqërisë së tyre.

SI TË APLIKONI PËR TË MARRË PJESË NË TRAJNIM?

Këto janë mënyrat për të aplikuar:

- Plotësoni formularin e regjistrimit bashkangjitur dhe dërgojeni me e-mail tek Olta Ceca, Menaxhere e Trajnimeve dhe Programeve në adresën: training@shukalb.al


- Shkoni tek Website i SHUKALB dhe regjistrohuni online: www.shukalb.al

TARIFAT*

Anëtarët e SHUKALB: 122,000 lekë për 3 persona.

Jo-anëtarët: 132,000 lekë për 3 persona.

**Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe për 4 ditët e trajnimit.*



SHUKALB

SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË



PLANI I BIZNESIT PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS BROSHURË TRAJNIMI

PLANI I BIZNESIT PËR SHOQËRITË UJËSJELLËS KANALIZIME NË SHQIPËRI

- A JENI TË PËRGATITUR TË NEGOCIONI MARRËVESHJEN TUAJ TË PERFORMANCËS ME QEVERINË?
- A JENI TË PËRGATITUR TË PËRMIRËSONI PERFORMANCËN FINANCIARE DHE OPERACIONALE TË SHOQËRISË SUAJ?

REGJISTROHUNI SOT PËR TË NDJEKUR KURSIN E TRAJNIMIT TË SHUKALB, “PLANI BIZNESIT PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS”

ËSHTË KOHA QË BASHKITË TË MARRIN NËN KONTROLL TË ARDHMEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIME

PËRQASJA E SHUKALB NDAJ ZHVILLIMIT TË TRAJNIMIT TË PLANIT TË BIZNESIT

Reformat e fundit në sektorin e ujit të miratua nga Këshilli i Ministrave si VKM Nr. 63, datë 27.01.2016, theksojnë faktin që shoqëritë e ujit duhet të menaxhohen me praktika të shëndosha si financiare, ashtu dhe teknike, si dhe një plan biznesi efektiv është elementi kyc për arritjen e këtij qëllimi.

Proçesi i planifikimit të biznesit është mënyra më e mirë për t’ju parashtruar drejtuesve të shoqërive UK çështjet kyçe që përcaktojnë suksesin e shoqërisë, në mënyrë që ata të përqëndrohen në përmirësime të matshme të performancës mbi baza rutin.

SHUKALB zotëron një kurs trajnimi të mirënjohur i cili jepet nga ekspertë të njohur shqiptarë, të cilët kanë zhvilluar trajnime të ngjashme në më shumë se pesë vende të botës, dhe kanë hartuar modelin standard të Planit të Biznesit për Shqipërinë nën financimin e Bankës Botërore. Të gjitha materialet e kursit të trajnimit si dhe Modeli i Planit të Biznesit në Excel janë të disponueshëm në gjuhën shqipe.

Kursi i Trajnimit të SHUKALB për Planin e Biznesit është më shumë sesa një kurs trajnimi, pasi në përfundim të tij, çdo shoqëri

pjesëmarrëse do të ketë hartuar një version draft të Planit të Biznesi, të cilin mund ta rishikojë dhe finalizojë në një fazë të mëtejshme me të gjithë drejtuesit e Shoqërisë dhe Bashkisë. Plani i Biznesit përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

VIZIONI DHE MISIONI I SHOQËRISË

Ky është hapi i parë në procesin e hartimit të Planit të Biznesit, edhe pse menaxherët që e ndjekin për herë të parë këtë proces, në fillim iu duken si fjalë pa kuptim, shumë shpejt ata kuptojnë se nëse nuk përcaktojnë qartë Vizionin dhe Misionin e shoqërisë së tyre, nuk mund ta përthejnë atë në veprime konkrete për të shkuar drejt suksesit.

PIKPAMJET E DREJTUESVE TË SHOQËRISË

Ky kapitull përgatitet mbasi Plani i Biznesit është përfunduar dhe ai i jep mundësinë drejtuesve të parashtrojnë në mënyrë të përmblodhur situatën aktuale të shoqërisë, si dhe të komunikojnë shqetësimet dhe përqasjen e tyre për përmirësimin e performancës së saj.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Objektivat strategjikë janë thelbësorë në procesin e hartimit të Planit të Biznesit, duke

qenë se identifikojnë objektiva të matshëm për përmirësimin e performancës së shoqërisë. Objektivat strategjike formulohen që të jenë **specifikë, të matshëm, realistë, të kufizuar në kohë** dhe **të miratuar**. Ky është momenti kur drejtuesit e shoqërisë fillojnë të trajtojnë pjesën më impenjative të punës për përgatitjen e Planit të Biznesit.

ANALIZA DHE PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR UJË

Menaxhimi i Kërkesës për Ujë nuk kuptohet mirë në vendet në zhvillim. Kjo është vecanërisht e vërtetë në vendet ku “numrat” asnjëherë nuk iu nënshtruan testit të realitetit komercial, dhe mungesat e ujit ishin thjesht një barrë që duhej ta mbante publiku, pa u ankuar. Në këto vende menaxhimi i kërkesës për ujë nuk ka qenë kurrë problem i menaxhimit. Ky proces, në modelin e kursit të trajnimit të **SHUKALB**, fillon të përllogarisë sasinë e ujit, duke e trajtuar si një produkt i prodhuar për tu shitur dhe jo për tu humbur.

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE PERSONELI

Duke qenë se performanca mund të arrihet vetëm nëpërmjet punës së punonjësve, struktura organizative dhe niveli i personelit janë komponentë kyç të Planit të Biznesit. Shpesh ndodh që shoqëritë ujësjellës kanalizime trajtohen si rezervë për të krijuar vende pune, duke rezultuar në mbingarkesën e tyre me personel. Kjo pjesë e Planit të Biznesit do të theksojë vendin që kostoja e pagave zë në buxhetin e përgjithshëm të shoqërisë, duke nënvizuar presionin që ushtron mbingarkesa me personel në nivelin e pagave që shoqëria mund të përballojë të paguajë.

PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PERFORMANCËS

Pasi janë përcaktuar qartësisht Objektivat Strategjike, Programi i Investimeve Kapitale dhe Struktura Organizative, drejtuesit e

shoqërisë mund të fillojnë me detajimin e programeve specifike të përmirësimit të performancës që duhet të ndërmerren për arritjen e Objektivave Strategjike. Programet e Përmirësimit të Performancës janë mjaft të detajuara, me afate të qarta për zbatimin e tyre dhe me objektiva të ndërmjetme.

BUXHETI 5-VJEÇAR I OPERIMIT DHE MIRËMBAJTJES

Bazuar në informacionin e mbledhur në hapat e mësipërm, drejtuesit, mund të vijnë, me llogaritjen e buxheti të operimit dhe mirëmbajtjes për pesë vitet e ardhshëm. Ndikim kritik në këtë buxhet kanë vendimet e marra nga drejtuesit e shoqërisë në lidhje me shpenzimet për fuqinë punëtore, energjinë dhe kimikatet. Këto tre elementë janë kryesorë në buxhetin e shumicës së shoqërive ujësjellës kanalizime. Drejtuesit e shoqërive UK do të mësojnë të vlerësojnë nevojën për krijimin e një fondi rezervë, i cili do të përdoret për rinovimin, riparimin dhe zvendësimin e kapitalit, si dhe për investimet e reja kapitale. Gjithashtu do të mësojnë mënyrën sesi të gjithë këto fonde rezerve mund të futen në buxhet si “shpenzime”, në mënyrë që të reflektohen siç duhet në llogaritje e nevojave për të ardhura.

PROGRAMI 5-VJEÇAR I INVESTIMEVE KAPITALE

Duke qenë se shpenzimet për investime kapitale kanë qenë tradicionalisht vendimmarrje e pushtetit qëndror, pushteti vendor dhe shoqëritë ujësjellës kanalizime kanë pak ose aspak ekspertizë dhe eksperiencë për zhvillimin e një programi investimesh kapitale, që ti përgjigjet prioriteteve të performancës me kosto efektive. Ky element i Planit të Biznesit është jashtëzakonisht i dobishëm në këtë aspekt dhe u demonstroi drejtuesve të shoqërive UK se nuk mund të mbështeten gjithmonë në grante apo kredi të buta nga donatorët dhe shteti.